

DREJTËSIA TRANZICIONALE

*Pasi që luftërat fillojnë në mendjen e
njerëzve edhe mbrojtja e pages duhet
të ndërtohet në mendjen e njerëzve!*



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Embassy of Switzerland



HYRJE NË DREJTËSINË TRANZICIONALE

Drejtësia tranzicionale është mënyrë për të adresuar shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në të kaluarën, në mënyrë që popujt të mund të ecin drejt paqes së qëndrueshme dhe eventualisht drejt pajtimit. Vendet në tranzicion shpesh ballafaqohen me trashëgiminë e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve serioze të kryera në të kaluarën, të cilat nuk mund të shqyrtohen nga strukturat ekzistuese gjyqësore.



Pse është drejtësia tranzicionale e rëndësishme ?

Viktimat e abuzimeve masive të të drejtave të njeriut kanë të drejtë të shohin autorët e krimeve duke u dënuar, të dinë të vërtetën dhe të marrin dëmshpërblimin. Roli i drejtësisë tranzicionale është të ndihmoj shoqëritë të kalojnë nga regjimi totalitar në një sistem demokratik, duke aplikuar këto mekanizma:

Ndjekjet dhe gjykimet

penale. Ndjekjet penale për krime lufte janë përpjekje për të vendosur para gjykatës përgjegjësinë penale të individëve, të cilët dyshohet se kanë kryer krime gjatë një konflikti të armatosur. Gjatë këtyre gjykimeve, individëve që gjinden fajtorë iu shqiptohet dënimi i merituar, zbulohen fakte të reja që ndihmojnë në gjetjen e së vërtetës dhe viktimave iu krijohet hapësira për të realizuar të drejtën për dëmshpërblim. Zbatimi i ligjit dhe vendosja e drejtësisë krijon ndjenjën e sigurisë dhe e kthen besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.

Komisionet e së vërtetës

janë mekanizma të zbulimit të së vërtetës që hetojnë dhe raportojnë mbi shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në të kaluarën. Ato ndihmojnë të kuptohen shkaqet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe japin rekomandime për riparimin sa më efikas të dëmeve.



Dëmshpërblimet

(Reparacionet) janë mënyrat përmes të cilave qeveritë kompensojnë viktimat për dëmet e pësuarat. Reparacionet kanë implikime materiale (p.sh., pagesat në para ose shërbimet shëndetësore) si dhe aspekte simbolike (p.sh., kërkim-faljet publike ose dita e përkujtimit).

Reformat institucionale

janë ndryshime në strukturën institucionale, ligjore dhe shtetërore të forcave të armatosura, policisë dhe gjykatave. Reformat sigurojnë funksionimin demokratik të këtyre institucioneve. Në të njëjtën kohë, ato garantojnë mos përsëritjen e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.



SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, (Jugosllavia), si shtet federal është formuar më 29 nëntor të vitit 1943. Shteti federativ jugosllav përbëhej nga gjashtë republika: Serbia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia si dhe nga dy krahina: Kosova dhe Vojvodina.

Pas 47 viteve unitet, si rezultat i përkeqësimit të gjendjes politike, ekonomike dhe veçmas rritjes së nacionalizmit në fillim të viteve '90-ta fillojnë konfliktet e armatosura, që shpien deri te shpërbërja e Jugosllavisë.

Lufta në Slloveni (Lufta Dhjetëditëshe)

Sllovenia ishte Republika e parë e cila u shkëput nga Federata dhe ajo shpalli pavarësinë më 25.06.1991. Në Slloveni është zhvilluar lufta prej datës 27 qershor deri në datën 7 korrik 1991, gjatë së cilës janë vrarë rreth 65 persona dhe rreth 320 të tjerë janë plagosur.

Lufta në Kroaci

Lufta në Kroaci ka filluar në muajin mars të vitit 1991 dhe ka zgjatur deri në muajin nëntor të vitit 1995 (4 vjet dhe 7 muaj). Sikurse Sllovenia, ashtu dhe Kroacia, e ka shpallur pavarësinë në datën 25 qershor të vitit 1991. Gjatë kësaj lufte janë vrarë apo janë zhdukur rreth 22.000 persona.

Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë

Në Bosnjë dhe Hercegovinë lufta ka filluar një vit më vonë se ajo e Kroacisë, pra në muajin mars të vitit 1992 dhe ka përfunduar në muajin dhjetor të vitit 1995, një muaj pas përfundimit të luftës në Kroaci. Gjatë luftës në Bosnjë, mbi 95.000 persona kanë humbur jetën apo janë zhdukur.

Lufta në Kosovë

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova mbeti pjesë e Serbisë në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) si krahinë Autonome.

Të pakënaqur me pozitën e tyre politike, shqiptarët e Kosovës

janë ngritur disa herë në demonstrata si ato të vitit 1968 me kërkesë për përdorimin e simboleve kombëtare dhe hapjen e universitetit në gjuhën shqipe. Në vitin 1974 është nxjerrë Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Kjo e fundit, së bashku me Kushtetutën e re të RSFJ-së, ndonëse e lanë Kosovën pjesë përbërëse të Serbisë, atë e ngritën në nivel të njësisë federale me të drejtë vetoje në organet federative. Përsëri në vitin 1981, studentët u ngritën në protesta, të cilat u kthyen në protesta gjithëpopullore me kërkesën për Kosovën Republikë. Vite më vonë, në vitin 1989 është bërë suprimimi i autonomisë së Kosovës.

Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë gjatë viteve '90-të mbeti jashtëzakonisht e vështirë. Gati të gjithë të punësuarit në sektorin publik u dëbuan nga puna, u mbyll universiteti dhe shkollat e mesme në gjuhën shqipe, shtypi dhe radiotelevizioni. Për t'u përballur me këtë sfidë, shqiptarët themeluan institucionet publike paralele në formë të rezistencës paqësore. Një numër i

konsiderueshëm i shqiptarëve u burgosën, keqtrajtuar e u vranë, ndërsa shumë të tjerë u detyruan ta lëshojnë vendin duke kërkuar azil në Evropën Perëndimore.

Si kundërpërgjigje ndaj represionit të vazhduar ndaj shqiptarëve në Kosovë u themelua Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), që kishte për qëllim pavarësimin e Kosovës. UÇK-ja u shfaq publikisht në datën 28 nëntor të vitit 1997. Kjo pasoi me intensifikimin e konfrontimeve në mes të UÇK-së dhe forcave serbe. Si datë zyrtare e fillimit të luftës në Kosovë njihet 28 shkurti i vitit 1998. Në fillim të vitit 1999, pas dështimit të negociatave për paqe (Rambuje dhe Paris), Aleanca Veri-Atlantike, NATO dhe aleatët e saj, filluan në datën 24 mars të vitit 1999 sulmet ajrore ndaj caqeve ushtarake jugosllave për 78 ditë me radhë. Lufta zgjati deri në datën 10 qershor të vitit 1999 dhe përfundoi me nënshkrimin e marrëveshjes së Kumanovës. Gjatë luftës në Kosovë, mbi 800.000 shqiptarë janë dëbuar nga vendi, ndërsa rreth 13.400 persona rezultojnë të vrarë apo të zhdukur nga të gjitha komunitetet.



Pamje nga procesi gjyqësor, gjykata e Nurembergut, Gjermani. Të akuzuar 23 liderët më të rëndësishëm politik dhe ushtarak të Rajhut të Tretë, për krime të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore.



**“ Padrejtësia
diku është
kërcënim për
drejtësinë kudo ”**

- Martin Luther King



E DREJTA PËR DREJTËSI – GJYKIMET

Ndjekjet dhe gjykimet penale janë veprime shumë të rëndësishme ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve serioze dhe duhet të ndërmerren kurdo që është e mundur. Ndjekjet fokusohen në individë dhe janë një hap tutje në rikthimin e dinjitetit të viktimave si dhe në kthimin e besimit në sundimin e së drejtës. Lëndët për krime lufte procedohen nga gjykata të ndryshme, siç janë: Gjykatat e përkohshme ndërkombëtare- Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruanda (TNPR), Gjykata e Përhershme Penale, Gjykatat e rregullta dhe Departamentet Speciale për Krime Lufte në nivel nacional dhe Gjykatat hibride/të përziera.



Lëndët e proceduara për krimet e luftës të kryera në Kosovë janë gjykuar nga:

TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË (TPNJ)

Në muajin maj të vitit 1993, Kombet e Bashkuara e kanë themeluar Tribunalin si përgjigje ndaj mizorive të shumta që po ndodhnin në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Raportet, që përshkruanin krime të llahtarshme ku mijëra civilë janë vrarë dhe lënduar,

torturuar dhe keqtrajtuar seksualisht në kamp-burgjet dhe qindra mijëra janë dëbuar prej vatrave të tyre, shkaktuan indinjatë anembanë botës dhe i shtynë Kombet e Bashkuara në veprim. TPNJ-ja është gjykata e parë për krime lufte e themeluar nga OKB-ja dhe Tribunali i parë ndërkombëtar për krime lufte që nga Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios.



Dhoma Speciale për Krime të Luftës në Serbi

Dhoma Speciale për Krime të Luftës në Serbi është themeluar në datën 1 korrik të vitit 2003 me qëllim që të zbuloj dhe ndjek penalisht kryerësit e veprave penale kundër njerëzimit, shkeljet e së drejtës ndërkombëtare dhe të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar.

ГЈЈКАТАТ HIБРИДЕ нѐ КОСОВѐ

Autoritetet e OKB-së, përmes rezolutës 1244, si dokument bazë, e kanë organizuar sistemin gjyqësor në Kosovë. Ky dokument lejon përfshirjen e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në gjykatat vendore. Panelet gjyqësore të përbëra nga gjykatës ndërkombëtar dhe vendor njihen si gjykata hibride apo të përziera.





Desmond Tutu, ish Kryepeshkopi i Cape Town, në Afrikë të Jugut, si dhe kreu i Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit, së bashku me Nelson Mandelën, ish President i Afrikës së Jugut.



MEKANIZMAT PËR ZBULIMIN E SË VËRTETËS

Shoqëritë dhe individët kanë të drejtë të dinë të vërtetën për shkeljet masive të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur ose të represionit. Të gjitha kulturat e njohin rëndësinë e të vërtetës, e cila është e domosdoshme për të arritur shërimin personal dhe kolektiv.

Çfarë janë Komisionet e së vërtetës?

Kërkimi i së vërtetës është nocion i gjerë që përfshin metoda të ndryshme të mbledhjes së informatave. Mënyra më e njohur e të kërkuarit të së vërtetës në kontekstin kalimtar është komisioni i së vërtetës. Të themeluara ad-hoc, ato autorizohen nga shtetet me qëllim të hetimit dhe të raportimit për periudha kyçe të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën. Përmes rekomandimeve, komisionet adresojnë masat, që duhet ndërmarrë nga shtetet për të riparuar dëmet e shkaktuara.

Të paktën 30 komisione zyrtare për të vërtetën janë themeluar në mbarë botën që nga viti 1974.





KOMRA – KOMISIONI RAJONAL

KOMRA është Komision Rajonal për faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga data 1 janar e vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001. Koalicioni për KOMRA-n është themeluar në vitin 2008 dhe i tubon mbi 2.050 organizata joqeveritare për të drejtat e njeriut, shoqata të ish të burgosurve të kampeve të përqendrimit, të refugjatëve, të familjeve të personave të pagjetur, artistë, shkrimtarë, juristë dhe individë të tjerë, të cilët janë të mendimit se qasja rajonale mund të sigurojë një regjistër të gjithmbarshëm historik lidhur me atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën.

Koalicioni për KOMRA-n deri në muajin mars të vitit 2011 e ka zhvilluar procesin konsultativ

mbi nevojat e viktimave dhe mbi mandatin e organit rajonal për zbulimin dhe paraqitjen publike të fakteve mbi krimet e luftës, shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, mbi viktimat dhe kryerësit e krimeve, në formën e 128 tubimeve lokale dhe rajonale dhe nëntë forumeve ndërkombëtare për drejtësinë tranzicionale. Në formësimin e Propozim Statutit të KOMRA-s kanë marrë pjesë 6.700 përfaqësues të shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat për të drejtat e njeriut, për viktimat, për familjet e viktimave, juristë, artistë, shkrimtarë dhe individë, profesionistë dhe individë të tjerë të interesuar që me angazhimin e tyre t'i kontribuojnë vendosjes së drejtësisë dhe pajtimit në rajonin e ish- Jugosllavisë.



SIPAS STATUTIT TË VET, KOMRA KA KËTO QËLLIME:

- 1.** të vërtetojë fakte për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e ish RSFJ-së, në periudhën nga data 1 janar e vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001, rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat, të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të të drejtave;
- 2.** të pranojë padrejtësitë që iu janë shkaktuar viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës për viktimat;
- 3.** të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave;
- 4.** të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në palët kontraktuese të pranojnë faktet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;
- 5.** të kontribuojë në ndriçimin e fatit të të pagjeturve;
- 6.** të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

KOMRA është në fazën e institucionalizimit. Të deleguarit personal të Presidentëve të të gjitha shteteve të dala nga ish Jugosllavia, gjatë vitit 2013 kanë mbajtur takime, në të cilat kanë diskutuar mundësitë ligjore dhe kushtetuese të këtyre shteteve për krijimin e përbashkët të KOMRA-s.

DËMSHPËRBLIMET (REPARACIONET)

Dëmshpërblimet/Reparacionet janë mekanizma që realizojnë të drejtën e kompensimit të viktimave për dëmet e shkaktuara nga shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut. Shtetet kanë përgjegjësi ligjore që të pranojnë dhe të adresojnë shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut, në rastet kur shteti i ka shkaktuar ato apo nuk ka ndërmarrë masa serioze për parandalimin e tyre.

Dëmshpërblimet mëtojnë të adresojnë dëmet e shkaktuara nga këto shkelje. Ato mund të marrin formë të kompensimeve për humbjet e përjetuara, të cilat ndihmojnë në tejkalimin e disa prej pasojave të abuzimit. Ato mund të jenë të drejtuar nga e ardhmja, duke ofruar rehabilitim dhe jetë më të mirë për viktimat.

LLOJET E DËMSHPËRBLIMEVE (REPARACIONEVE)

Materiale janë:

Kompensimet monetare
Kthimi i pasurisë
Triska individuale për shërbime të ndryshme në shëndetësi, arsim, banim etj.

Simbolike janë:

Letra formale të kërimit të faljes nga Qeveria (Ri)varrimi i viktimave
Dita Kombëtare e Përkujtimit
Hapësira të dedikuara publike (si parqe/muze/memoriale)

“ Për dhimbjen dhe vuajtjen e atyre gjeneratave të vjedhura, për pasardhësit e tyre dhe për familjet e tyre të lëna pas, ne kërkojmë falje. Për nënat dhe baballarët, për vëllezërit dhe motrat, për ndarjen e familjeve dhe të komuniteteve, ne kërkojmë falje. Dhe, për përruljen dhe për degradimin e një populli krenar dhe një kulture krenare, ne kërkojmë falje ”

– *Kevin Rudd*

(Pjesë e shkëputur nga fjalimi i Kryeministrit të Australisë Kevin Rudd, ku iu ka kërkuar falje aborigjenëve dhe veçanërisht i ishte drejtuar “gjeneratave të vjedhura”)

Kancelari i Gjermanisë
Willy Brandt, duke u
gjunjësuar para
memorialit, në ditën e
përkujtimit të viktimave
hebraike në Varshavë
të Polonisë)



REFORMAT INSTITUCIONALE

Reformat institucionale i referohen transformimit të institucioneve publike që i kanë kontribuar konfliktit apo i kanë shërbyer një regjimi represiv. Procesi i reformimit institucional duhet të transferoj ato institucione në institucione efektive dhe të drejta që ruajnë paqen dhe mbrojnë sundimin e ligjit. Reforma institucionale promovon përgjegjësinë dhe ndihmon parandalimin e përsëritjes së dhunës.

Reforma institucionale është proces i rishikimit dhe i ristrukturimit të institucioneve shtetërore në mënyrë që ato të respektojnë të drejtat e njeriut, të sigurojnë sundimin e ligjit dhe të japin llogari publike.

Reformat institucionale mund të përfshijnë shumë masa të bazuara në drejtësi, të tilla si:

Verifikimi (Vetting)

Largimi i zyrtarëve të korruptuar nga administrata publike përmes procedurave të verifikimit – largimi i shërbyesve civil nga institucionet (si policia, burgjet, armata) dhe zëvendësimi i tyre me njerëz që mund të jenë shërbyes civil më të mirë.

Reforma strukturore

Ristrukturimi i institucioneve për të promovuar integritetin dhe legjitimitetin, duke siguruar llogaridhënie, ndërtimin e pavarësisë, duke siguruar përfaqësim, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Mbikëqyrja

Krijimi i organeve mbikëqyrëse brenda institucioneve shtetërore për të siguruar përgjegjshmërinë në qeverisje civile.

Transformimi i kornizave

ligjore

Reformimi ose krijimi i kornizave të reja ligjore, të tilla si miratimi i amendamenteve kushtetuese apo i traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për

të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Çarmatimi, demobilizimi dhe ri-integrimi

Shpërbërja e aktorëve të ndryshëm të armatosur si p.sh., grupeve paramilitare – si dhe krijimi i kushteve të favorshme për integrimin e ish-luftëtarëve në shoqëri.

Edukimi

Programet e trajnimit për zyrtarët publik dhe të punësuarit mbi të drejtat e njeriut si dhe standardet ndërkombëtare të së drejtës humanitare.



Çarmatimi



Adr: Eqrem Çabej 7A
10000, Prishtinë
Tel: +381 38 243 488
Fax: +381 38 243 490
Mobile: +377 (0)44 944 755
Email: office@hlc-kosovo.org